



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A

Durrës, më _____.____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

‘BLERJE PLUHUR HIPOKLORIT KALCIUMI’

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,980,000.00 (KATËR MILION E NËNTËQIND E TETËDHJETË MIJË)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KIMIKATE PËR TRAJTIMIN E UJIT 24962000-5

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për bilancet për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022 të certifikuar nga organet tatimorë. ku vlera mesatare e xhiros për të paktën një nga tre vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sipas nenit 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik ka të gjitha kapacitetet financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke ju referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet se kjo vlerë është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvoja të mëparshme të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen qartë datat ,vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,
- b) Për përvoja të mëparshme të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit**,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme bazohet në nenin 55 pika 4/b, të VKM nr 285 datë 19.05.2021. “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë punonjës si më poshtë

- a) 1(një) drejtues mjetei ADR

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, **për punonjësin “Drejtues mjetei”** operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Leje drejtimi
- Kontratë pune të vlefshme.

Shënim: Ne rast se mjetet janë me qera OE duhet të paraqes kontratat e punës për punonjësit “Drejtues mjeti” me subjektin që ka lidhur kontrates e qerase se mjeteve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të ketë në pronësi/qera

a) 1 mjet të autorizuar, për transport të mallrave të rrezikshme sipas standartit të BE.

Mjetet që transportojne kimikate duhet te jene te pajisur me certifikate (ADR) per transport mallrash të rrezikshëm.

Për të vertetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqesë:

,

- Lejen e qarkullimit,
- Certifikatën e kontrollit teknik,
- Siguracionin e mjetit (të vlefshme)
- Certifikatë pronësie të mjetit
- certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat e rrezikshme.

Githashtu dhe për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqesë:

- Kontrata e qerasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe të mbulojë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës. Së bashku me certifikatën e pronësisë.
- Lejen e qarkullimit,
- Certifikatën e kontrollit teknik,
- Siguracionin e mjetit (të vlefshme)për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat e rrezikshme.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejten të verifikojë dhe kontrollojë në cdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruar.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet të certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Automjeti duhet të jetë i përshtatshëm për të mbajtur mallra të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm.

2.3.4 OE duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, dhe shpenzimet e parashikuara në shtojcën 5 të specifikimeve teknike.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë I pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që janë në përputhje me objektin e kontratës. Certifikatat kerkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës. si më poshte:

1. ISO 9001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit dhe në përputhje me objektin e prokurimit.. Në këtë certifikatë personale duhet të përfshihet objekti i prokurimit.
2. ISO 14001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të mjedisit. e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit dhe në përputhje me objektin e prokurimit.

3. ISO 45001-2018 ose ekuivalente ne fushen e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet te dorezojne certifikatat ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit)

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” **Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor** dhe neneve 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

-Cerifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise **ISO 9001:2015** eshte e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyren dhe vleren e kontrates, me qellim per te vertetuar dhe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates.

-Cerifikata per sistemin e menaxhimit te mjedisit **ISO 14001:2015** e kerkuar nga AK garanton se OE ofruet do te sjelle produkte te cilat nuk demtojne mjedisin dhe nuk e ndotin ate dhe qe jane konform standarteve nderkombetare te cilesise. Kerkesa ne lidhje me keto certifikata eshte ne perputhje me nenin 44, te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public”, dhe nenin 79, te Nr 162, date 23.12.2020 “Per rregullat e prokurimit publik”.

-Cerifikata per sistemin e menaxhimit e shendetit dhe sigurise në punë **OHSAS 18001:2007** ose ekuivalente te njohura nga standartet shqiptare **ISO 45001-2015** ka nje rendesi te vecante per kryerjen e kesaj kontrate.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikatën e prodhuesit** që vërteton konformitetin e produktit në prokurim me normat Europiane SSH(EN901: 2013). Produkte kimike për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, Ca(OCl)2.

Argumentim: Ky kriter eshte menduar per ti dhene sigurine AK qe OE ofruet do te paraqese mallra, te cilat permbushin kerkesat e specifikimeve teknike dhe jane ne perputhje me to. Ky kriteri eshte vendosur ne perputhje me piken 8, te nenit 40, te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, dhe nenin 79, te ligjit Nr. 162 date 23.12.2021 “Per prokurimin publik”

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e furnizimit me nje importues të mallrave dhe lejen e importit të importuesit lëshuar nga QKL për kimikatin e përcaktuar në DST (nëse është rasti i importit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është menduar për të dhënë siguri AK që OE ofrues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe në përputhje me to. Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 5, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletën e analizës toksikologjike nga Instituti i Shëndetit Publik, ose laboratorë të certifikuar, të bërë brenda tre muajve të fundit dhe fletë analize nga prodhuesi me parametrat përkatës bazuar në standartin EN 901:2013 ose ekuivalente S SH EN 901:2013.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se hipokloriti i kalciumit është konform standarteve për trajtimin e ujit të pijshëm. Duhet të paraqitet dokumentacioni nga prodhuesi që provon se produkti plotëson standartet S Sh /EN 901 :2013.

2.4.5 Operatori ekonomik që është prodhues vendas duhet të paraqesë leje mjedisore të kategorisë “A” për impiante të industrisë kimike, sipas Ligjit nr 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” I ndryshuar. Për operatorët vetëm tregtues duhet të paraqesin leje mjedisore “ për magazinim kimikatesh.B”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar . gjithashtu edhe në Ligjin Nr 10448, dt 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” I ndryshuar

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra si më poshtë:

1. Hipoklorit Kalciumi 60/-70%

Për të përmbushur këto kriter, OE ofrues duhet të paraqesë një deklaratë ku jep: miratimin për kryerjen e analizave, të dhenat e kontaktit, në mënyrë që të kontaktohet dhe të jete i pranishëm në momentin e marrjes së mostres dhe dergimit të tyre pranë laboratorit. Gjithashtu, duhet të deklarojë se merr përsipër kryerjen e pagesës së tarifës për kryerjen e analizave pranë laboratorit.

Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mos paraqitja e mostrave përbën kusht për s’kualifikim.

Argumentim: Ky kriter është hartuar, në mënyrë që vlerësimi i mallrave të bëhet sa më i saktë dhe duke qenë se mostrat e paraqitura nuk mund të vlerësohen në përberjen e tyre në kushtet e punës në AK vlerësimi i ofertave do të mbështetet në analizat laboratorike të bëra nga institucione të akredituara. Kriteri i kërkuar në lidhje me analizën e mostrave, është vendosur në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM Nr 285. Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.4.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara me kapitale DST.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike te Hipokloritit te Kalciumit Ca(ClO)₂

ne mg/Kg te klorit aktiv 60-70%

Nr.	Parametrat	Njesia Matjes	Specifikimet Kimike
1	Gjendja	-	Granular
2	Ngjyra	-	bardhe e hapur
3	Titulli I CL ₂	% m/m	60-70
4	Kadmium (Cd)	mg/Kg	max 5
5	Krom (Cr)	mg/Kg	max 2.5
6	Nikel (Ni)	mg/Kg	max 20
7	Plumb (Pb)	mg/Kg	max 20

Hipokloriti I kalciumit duhet të jetë në përputhje me parametrat e Komunitetit Europian. Jetëgjatësia jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Automjetet duhet të jenë të certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standarteve te BE për produktë që trajtojnë ujin e pijshëm.

Certifikata e origjinës dhe raport analiza duhet të jenë gjatë furnizimit periodik.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës do të jetë :

Zona Kavajë

Zona Rrogozhinë